

Njoftim për përqendrim me të cilin Vited Megakorp Oyj, Helsinki, Kaikukatu 4C, do të fitojë kontroll mbi Softver Sauna d.o.o. Zagreb, Republika e Kroacisë

(lënda nr. 08-132/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 03.09.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim me të cilin Vited Megakorp Oyj, me seli të regjistruar në Finlandë, 00530 Helsinki, Kaikukatu 4C, synon të fitojë kontroll të pavarur mbi Softver Sauna d.o.o., me seli të regjistruar në rrugën Stara Knezhija 20, 10000 Zagreb, Republika e Kroacisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

Vited Megakorp Oyj është një kompani softuerike finlandeze e themeluar në vitin 2016, e cila ofron konsulencë për zhvillimin e softuerit dhe realizimin e projekteve, si dhe konsulencë për rritje dhe shërbime rekrutimi për të mbështetur klientët në lidhje me zhvillimin e tyre të softuerit.

Vited Megakorp Oyj punëson 339 profesionistë të IT-së. Përveç në Finlandë, Vited Megakorp Oyj operon në Norvegji dhe Suedi dhe gjithashtu realizon projekte në tregje të ndryshme. Në Finlandë, Vited Megakorp Oyj ka rreth 150 klientë, të cilët janë kryesisht kompani të mëdha dhe brende të njohura.

Vited Megakorp Oyj nuk ka prani të regjistruar në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka realizuar asnjë të ardhur në Maqedoninë e Veriut në vitin 2024.

Softver Sauna d.o.o. është një kompani softuerike kroate e themeluar në vitin 2018, e cila u ofron klientëve të saj shërbime për zhvillimin e softuerit dhe të dhënave dhe shërbime për zhvillimin e inteligjencës artificiale.

Softver Sauna d.o.o. specializohet në ndërtimin e ueb-aplikacioneve që përpunojnë një numër të madh përdoruesish njëkohësisht (*high-traffic web applications*) dhe specializohet në shkallëzimin e infrastrukturave të shpërndara (*scaling distributed infrastructures*), për të cilat shpesh nevojiten burime shtesë që sigurohen përmes outsourcing-ut.

Ekspertiza e Softver Sauna d.o.o. konsiston në ndihmën e klientëve kyç në themelimin, shkallëzimin dhe menaxhimin efektiv të ekipeve efikase që punojnë në distancë.

Softver Sauna d.o.o. ka prani të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërisë së saj në pronësi të plotë:

- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime SOFTVER SAUNA SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në adresën Bul. Koço Racin nr. 8-Kulla/B15 Shkup – Qendër, me NUAS 7571186 dhe veprimtari parësore të regjistruar 62.100 – Programim kompjuterik.

Shoqëria e varur maqedonase e Softver Sauna d.o.o. ka vetëm klientë të huaj dhe nuk ka, dhe nuk planifikon të ketë, asnjë shitje afariste në Maqedoninë e Veriut. Tregu kryesor i synuar i Softvaer Sauna është Finlanda dhe vendet e tjera skandinave.

Parashtruesi konsideron se tregu relevant i mallrave për përqendrimin e njoftuar në Maqedoninë e Veriut, duke marrë parasysh aktivitetet afariste të Shoqërisë së synuar, mund të përkufizohet si **tregu për ofrimin e shërbimeve të IT-së**.

Sa i përket shtrirjes gjeografike të tregut të përqendrimit në fjalë, për qëllimet e këtij Njoftimi, Parashtruesi propozon që tregu relevant gjeografik të përkufizohet në **nivel kombëtar**.

Bazuar në hetimin paraprak, Komisioni ka konstatuar se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni u bën thirrje palëve të treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe ato duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

04.09.2025

Shkup